



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 178, datë 28.12.2017

**MBI MARRJEN E MASAVE PËR KORIGJIMIN E SITUATËS QË LIDHET ME
SHITJET E POLICAVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MTPL**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si dhe neneve 194 e vijues të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

K O N S T A T O I S E:

Në mbështetje të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, nenit 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, në bazë të autorizimit për inspektim nr. 800 prot, datë 18.10.2017 dhe programit të inspektimit nr. 848 prot, datë 02.11.2017, është ushtruar inspektim në vend pranë pikave të shitjeve të policave të sigurimit MTPL të shoqërive të sigurimit, që ndodhen pranë Qendrës së Kontrollit Teknik në Urën Vajgurore më datë 18.10.2017 dhe pranë Qendrës së Kontrollit Teknik në Tiranë, më datë 03.11.2017.

Nga inspektimi i kryer, janë konstatuar disa shkelje që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së agjentit/punonjësit të disa shoqërive të sigurimit.

Përsa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Shoqëritë e sigurimit me qëllim parandalimin e veprimeve që përbëjnë shkelje të ligjit dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe për të korrigjuar situatën problematike që paraqet tregu të marrin masa si më poshtë:

- i. Kontratat e sigurimit të detyrueshëm MTPL, duhet të shiten vetëm nëpërmjet regjistrit elektronik online të shitjeve, në zbatim nenit 38, të Ligjit nr. 10076,

- datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar si dhe Rregullores nr. 3, datë 03.10.2007 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik ”, e ndryshuar.
- ii. Nënshkrimi i kontratave të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta të bëhet vetëm nga ndërmjetësit në sigurime ose nga punonjës të shoqërive të sigurimit.
 - iii. Shoqëritë e sigurimit të depozitojnë në Autoritet listën e punonjësve të autorizuar për nënshkrimin e kontratave të sigurimit, si dhe dokumentin që vërteton se është punonjës pranë kësaj shoqërie sigurimi.
 - iv. Agjentët në sigurime nuk duhet të ushtrojnë veprimtari të tjera përveç atyre që parashikohen në legjislacionin në fuqi.
 - v. Agjentët në sigurime duhet të disponojnë policën e sigurimit të përgjegjësisë, sipas nenit 197, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
 - vi. Çdo agjent ose punonjës në ambientet që ushtron veprimtarinë të ketë të afishuar në vende të dukshme:
 - a. Tarifat e primit të sigurimit të detyrueshëm konform legjislacionit në fuqi;
 - b. Kopje të kushteve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm;
 - c. Licencën e agjentit ose autorizimin e punonjësit për të nënshkruar kontrata sigurimi.
 - vii. Çdo agjent ose punonjës duhet të pajiset me dokument identifikimi (shenjë dalluese) i cili të jetë lehtësisht i identifikueshem nga publiku dhe të përmbajë të paktën këto elementë: emër, mbiemër si dhe statusin e personit që nënshkruan kontrata sigurimi (agjent/punonjës), logon e shoqërisë së sigurimit, numrin e licencës dhe vlefshmërinë e saj/kontratës dhe vlefshmërinë e saj (kur është agjent/punonjës). Çdo ndryshim i të dhënave mbi bazën e së cilës është marrë miratimi/licenca duhet të jetë objekt i njoftimit në Autoritet.
 - viii. Agjentët ose punonjësit e shoqërisë së sigurimit nuk kanë të drejtë të autorizojnë asnjë person tjetër që të nënshkruajë kontratat e sigurimit në emër dhe për llogari të tij, sipas pikës 4 të nenit 198 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
 - ix. Çdo agjent ose punonjës duhet të jetë përgjegjës për plotësimin me rigorozitet të elementëve të policës së sigurimit si dhe duhet të përmbajë integritet dhe etikë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
 - x. Agjentët ose punonjësit duhet të mbajnë inventarin e saktë të policave të sigurimit, të furnizuara nga shoqëria e sigurimit, librin e shitjeve të policave të sigurimit si dhe të plotësojnë çdo kërkesë të përcaktuar në nenin 17, të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015.
 - xi. Çdo agjent ose punonjës gjatë ushtrimit të inspektimit nga ana e Autoritetit, duhet të vërë në dispozicion gjithë dokumentacionin e kërkuar.

2. Afati për marrjen e masave për korrigjimin e situatës së mësipërme do të jetë deri më 15.01.2018.
3. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi i bëhet i njohur të gjitha shoqërive të sigurimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI